



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 54

Datë: 27.11.2020. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
2. Aktivitetet e SKQZ-së:
3. Aktivitetet e ZRPPC-së:
4. Raporti i Këshillave të KQZ-së:
 - **Këshilli për Çështje Ligjore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Obiliq.
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe Miratimi i propozimit të KKZ-së në Podujevë lidhur me votimin e personave të infektuar me COVID-19,
 - Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.
5. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 54-t të KQZ, a ka dikush vërejtje. Kush është për këtë rend dite? Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës!

2. Aktivitetet e SKQZ

Burim Ahmetaj: Sekretariati, ende është në proces të përgatitjeve, është bërë vlerësimi i një plani operacional. E keni pasur edhe në imell, e keni edhe të printuar përpara vetes...! Me shpërndarjen e materialit në terren, dhe me operacionalizimin e proceset e tjera që janë në plan, çdo gjë është në nivelin e kërkuar të KQZ.

Alim Rama: E kam lexuar me vëmendje raportin, por disa aktiviteteve të prokurimit nuk kanë mundur disa aktivitete të zbatohen. Dhe unë, propozoj që në zgjedhjet e tjera të ketë kontrata – kornizë, dhe të realizohet plani. Për shembull, kartolinat nuk kanë mundur të dërgohen me kohë, kështu që duhet me kohë të realizohen proceset...

Valdete Daka: Po, gjithë kemi pasur këso probleme sepse, pothuajse gjithë po mbajmë zgjedhje të parakohshme...

Sami Hamiti: Po, kjo është e drejtë por shpesh, nuk varet as prej procedurave të prokurimit, ndërsa për zgjedhjet e rregullta plani duhet bërë përpjekje të realizohet me kohë, të përfillen procedurat, por tash s'i në këtë rast, vështirë është e mundur sepse procedurat varen nga faktorë të tjerë...

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Yll Buleshka: ZRPP, është në përfundim të të gjitha aktiviteteve. Kemi procesuar vëzhguesit, por ajo që vlen të përmendet, vëzhguesit mund të lëvizin duke e siguruar zyra lejen e carkullimit, dhe se kemi shqyrtuar edhe specifikat që duhet zbatuar nga vëzhguesit për shkak të covid – 19...

Alim Rama: Nuk kemi marrë vendim se sa vëzhgues duhet të jenë në vendvotim...!

Valdete Daka: Zakonisht, janë 2 nga secili subjekt që mundet m'i pas, mirëpo kemi pasur raste kur kemi vendosë me qenë vetëm nga 1 vëzhgues...Mirë kish qenë nesër me marrë vendim dhe me i njoftue subjektet...

4. Raporti i Këshillave të KQZ-së

1. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Obiliq:

Arianit Elshani: Së pari, deshta të ngris një çështje që është diskutuar edhe në këshill, dhe meqë kemi të drejtë të informohemi edhe s'i KQZ, pra ën këtë rast lidhur me shkresat ndërinstitucionale: ato që ju adresohen ju, dhe kryeshefit...Pra, me komunikimin ndërinstitucional...

Valdete Daka, dha shpjegime lidhur me këtë pjesë të diskutimit, dhe diskutoi shkresat e fundit që kanë ardhur në KQZ.

Arianit Elshani: Jo, po mendoj që ne të informohemi lidhur me komunikimin me institucione të KQZ - së nga mediat, ose ngjashëm...

Sa i përketë rendit të ditës, Këshilli ka shqyrtuar kërkesën për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Obiliq, dhe se kërkesa është në rregull sipas procedurave dhe me shumicë votash në këshill, është rekomanduar që KQZ ta miratoj këtë zëvendësim...

Valdete Daka: Kush është për që z. Lulzim Bllaca të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Obiliq nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm z. Muhamet Mustafa.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

5.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe Miratimi i propozimit të KKZ-së në Podujevë lidhur me votimin e personave te infektuar me COVID-19,

Alim Rama: Këshilli, ka pranuar një kërkesë nga KKZ në Podujevë lidhur me personat e infektuar me covid gjatë ditës së zgjedhjeve. Shkresën e keni para jush...! Ne, e kemi shqyrtuar dhe e rekomandojmë për aprovim. Këtu, ne e kemi kërkesën vetëm për Podujevë, por unë propozoj që e njëjta, të vlejë edhe për Mitrovicën e veriut.

Në këtë pikë, diskutuan: Eshref Vishi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Valdete Daka. Shpjegime, mbi këtë pikë, dha Burim Ahmetaj, kryeshef duke theksuar se përkundër mangësive të IKSHP-së mirëpo, ne kemi mekanizmat e verifikimit se a duhet të votoj me kusht apo s'i i rregullt... Arianit Elshani, kërkoi që ekipet mobile mos të lejojnë që personat e tjerë, veç atyre me covid, të mos lejohen të votojnë aty - për aty, por të shkojnë në QV. Ndërsa, Valdete Daka, tha se duhet të njoftohen të gjithë personat me covid që ata nuk mund të dalin, dhe se nuk mund të shkojnë në QV dhe të votojnë pastaj dy herë, sepse ata bëjnë dy vepra penale...

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e KQZ-it në mënyrë unanime.

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.

Alim Rama: Këshilli, sot po ashtu, e ka trajtuar listën e zëvendësimeve, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, të anëtarëve të KVV-e, për shkak se disa, janë paraqitur me covidn – 19, në ndërkohë...!

Valdete Daka: Atëherë, kush është për miratim të kësaj liste ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë listë.

6.Të ndryshme.

Sami Kurteshi: Po, është çështja që e ngriti kolegu dhe është çështje e informimit...! Nuk po them në kohë reale, por informimi i anëtarëve përfshinë edhe komunikimin e KQZ-së me institucionet e tjera; por, po përmend se janë marrja e shkresave, dërgimi i shkresave, përfaqësimi etj., i KQZ me institucionet tjera. Ju, thatë se keni marrë ftesën por nuk keni marrë ftesën s'i "Valdete Daka" pro, ju e keni marrë ftesën s'i kryetare e KQZ-së, dhe jo ndryshe...

Çështja tjetër është e komunikimit zyrtar mes KQZ dhe Gjykatës Kushtetuese...

(p.s. Këtu përfundon stenogrami...)